



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 18 mars 2011
Nr.ref.: RK 110/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 62/10

Parashtruesi

Azem Ademi

kundër

Ministria e Drejtësisë

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Azem Ademi, qytetar i Republikës së Kosovës.

Objekti i çështjes

2. Parashtruesi i kërkesës pohon se Ministria e Drejtësisë i ka shkelur të drejtat e garantuara me nenin 24 (Barazia para ligjit) dhe me nenin 35 (Liria e lëvizjes) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Baza juridike

3. Neni 113.7 i Kushtetutës së Kosovës; neni 20 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), dhe Rregulli 36 i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Procedura në Gjykatë

4. Më 12 korrik 2010 parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në sekretarinë e Gjykatës Kushtetuese.
5. Më 15 korrik 2010 parashtruesi i kërkesës e njoftoi Gjykatën se procedura që ishte duke u zhvilluar pranë Avokatit të Popullit tashmë kishte mbaruar.
6. Më 22 shkurt 2011 pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarës raportuese, Snezhana Botusharova, kolegji shqyrtues, i përbërë nga Almiro Rodrigues (kryeues), Gjyljeta Mushkolaj dhe Kadri Kryeziu i rekomanduan Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve dhe ankesave

7. Parashtruesi i kërkesës është i pakënaqur me statusin e tij pas kthimit në Kosovë nga një vend i Bashkimit Evropian ku kishte jetuar nga viti 1994 deri në vitin 2002.
8. Prandaj ai u paraqit në Ministrinë e Drejtësisë dhe i dorëzoi një numër kërkesash me shkrim në vitet 2008, 2009 dhe 2010, të emëruar, mes tjerash, "Kompetencat e Ministrisë për të vendosur në lidhje me ekstradimin". Sipas parashtruesit të kërkesës, Ministria duhet të vendos në lidhje me ekstradimin e tij (vullnetar) nga një vend i Bashkimit Evropian (BE) dhe t'i japë atij disa të drejta që u takojnë qytetarëve të atij vendi.
9. Pasi që Ministria e Drejtësisë nuk i ka miratuar kërkesat e tij, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese që të urdhërojë Ministrinë e Drejtësisë t'i paguajë atij kompensim në të holla për pagat mujore që do t'i kishte marrë ai gjatë tetë vjetëve, po të kishte qëndruar dhe punuar në atë vend të BE-së.
10. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu konsideron se ai duhet të kthehet në vendin e tij të punës dhe se duhet t'i jepet nënshtetësia e atij vendi. Ai pohon se pastaj do të mund të vazhdonte studimet atje.
11. Parashtruesi i kërkesës pohon se ai gjithashtu është në pritje të licencimit të një patenti nga shitja e të cilit, sipas tij, ai mund të fitojë një shumë të madhe parash.

Vlerësim i pranueshmërisë të kërkesës

12. Në mënyrë që të vendosë për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe Rregullore të Punës.

13. Në këtë kuptim, Gjykata përkujton se sipas rregullit 36(1)(c) "Gjykata mund të shqyrtojë kërkesat vetëm nëse kërkesa është qartazi e bazuar."
14. Rregulli 36 (2) i Rregullores së Punës me tutje parashikon që;
- "Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se:*
- a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose*
- b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose*
- c) Gjykata gjen se parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të së drejtave të garantuara me Kushtetutë, ose*
- d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."*
15. Parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë fakt prima facie që do të tregonte shkelje të të drejtave të tij të kushtetuese (shih Vanek kundër Republikës Sllovaqe, GJEDNJ Vendimi në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99 të 31 majit 2005).
16. Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për, ndër të tjera, kompensimin në të holla për pagat mujore që nuk i ka fituar për një periudhë prej 8 vitesh, për kthimin e tij në vendin e mëparshëm të punës në një vend të BE-së, për të drejtën e tij për nënshtetësi të huaj të BE-së dhe për të drejtën për të vazhduar studimet në një vend të BE-së janë plotësisht të paargumentueshme. Prandaj, kërkesa e parashtruesit nuk është arsyetuar prima facie.
17. Në të vërtetë faktet ashtu siç janë paraqitur nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk i mbështesin pretendimet se atij i janë shkelur drejtat nga veprimet e Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Kosovës.
18. Rrjedhimisht, kërkesa duhet të hidhet poshtë si qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, dhe Rregullin 36 të Rregullores së punës, njëzëri

VENDOS

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme.

Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues

Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani

